


**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**" E R B " S h . p . k**



Ne baze te ligjit 7638, date 19.11.1992 ne ortaket

1. **Zoti Bujar Qirko**, i biri i Sokratit, lindur në Gjirokaster më 24.02.1948, banues në Tirane, qe mban pasaporten me Nr. Z 0000128
2. **Zoti Maksim Muçi** i biri i Thimjos, lindur në Gjirokster më 12.01.1948, banues në Tirane, qe mban pashaporten me Nr. Z 0667780
3. **Zoti Fredi Muçi** i biri i Thimjos, lindur në Gjirokaster më 14.09.1952, banues në Gjirokaster , qe mban pashaporten me Nr. Z 1149800

Vendosem qe te krijojme Shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "E R B "shpk.

**KREU 1**

**FORMA, EMERTIMI I SHOQERISE, OBJEKTI, SELIA, KOHEZGJATJA**  
**NENI 1**

**NENI 1**

Shoqëria krijohet dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe veçanërisht, por jo ekskluzivisht, me Ligjin Nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare"; Ligjin Nr.7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare"; aktet e tjera ligjore që do të jenë në fuqi gjatë veprimtarisë së shoqërisë, si dhe me dispozitat e Statutit të Shoqërisë që i bashkëngjitet këtij Akti Themelues.

**NENI 2**

Emërtimi i Shoqërisë është "ERB" Sh.p.k.

**NENI 3**

**SELIA**

Selia e Shoqërisë ndodhet në Tirane, ne adresen: Rruga "Gjon Muzaka" Nr. 40/2, me te drejte per te ndryshuar qendren e saj si dhe per te hapur dege e filiale te tjera, agjensi perfaqesimi ne te gjithe Shqiperine si dhe jashte saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

**NENI 4**

**KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE**

- 1 -

Kohezgjatja e kesaj shoqërie do te jete me nje afat kohe mbi 10 vjet, duke filluar nga data e regjistrimit ne gjykate.

Kjo periudhe mund te zgjatet tej ketij afati ose te shkurtohet kur shoqëria priset para afatit.

## NENI 5

### OBJEKTI I SHOQERISE

Shoqëria do te kete si objekt te veprimtarise se saj:


- Mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertim- montimit, studimin dhe projektimin e objekteve,
- Konsulencen dhe kontrollin teknik te projekteve, vleresimin e pasurive te lujtshme e te palujtshme dhe çdo veprimtari tjetër ne perputhje me licensat e fituara te saj.
- Prodhimin e materialeve te ndertimit dhe tregtimin e tyre, import eksportin e mallrave te ndryshme makinerive pajisjeve etj. ne te gjithe territorin e Republikës se Shqipërisë dhe jashte saj.
- Kryerjen e veprimtarise se sherbimeve te ndryshme te karakterit mekanik, elektrik, elektronik, komunal, publicistike etj.
- Investimin e kapitalit dhe mjete të tjera financiare, për blerje të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme dhe në vazhdim të aktivitetit të saj të shesë të tilla, për të arritur qëllimet e Shoqërisë, apo të tjera, por që janë të vlefshme për të.
- Studimin dhe krijimin e linjave te prodhimit te çdo lloj artikulli te gatshem apo gjysem te gatshem, ndertimin- montimin e objekteve te ndryshme.
- Kryerjen e të gjitha operacionet bankare apo financiare si: depozitime, kreditime, likuidime të parave, etj., në kushtet e përcaktuara nga legjislacioni shqiptar. Dhënie e konsulencës dhe kryerjen e shërbimeve në lidhje me veprimtaritë e mësipërme dhe ne te tjera.
- Realizimin e kontratave, marrëveshjeve, ortakërive, shoqërive të përbashkëta tregtare, industriale, apo forma të tjera të lejuara nga legjislacioni shqiptar, me persona fizikë dhe juridikë, shqiptarë ose të huaj, për të realizuar veprimtari të ndryshme që janë të nevojshme dhe me interes për Shoqërinë.

## NENI 6

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 leke. Ky kapital përbëhet nga kontributet e mëposhtme :

1. Z. Bujar Qirko, kontribuon në shumën 33,3 % te kapitalit ose 1/3 te kuotave, me vlere 33.300 ( tridhjetë e tremije e treqind ) leke.
2. Z. Maksim Muçi, kontribuon në shumën 33,3 % te kapitalit ose 1/3 te kuotave, me vlere 33.300 ( tridhjetë e tremije e treqind ) leke.
3. Z. Fredi Muçi, kontribuon ne shumen 33,3 % te kapitalit ose 1/3 te kuotave, me vlere 33.300 ( tridhjetë e tremije e treqind ) leke.

Fondet qe rrjedhin depozitohen ne Banken perkatese ne llogari te shoqërisë qe krijohet. Kapitali Themeltar mund te shtohet ose pakesohet me vendim te Asamblese se Ortakeve. Çdo ndryshim i kapitalit themeltar pasqyrohet ne librin e shoqërisë. Kapitali mund te rritet edhe me kontributet ne natyre. Ndryshimi i kapitalit kryhet me



propozim te ortakeve dhe me miratimin e Asamblese se Ortakeve. Kapitali mund te rritet edhe me kontributet ne natyre.

Ndryshimi i kapitalit kryhet me propozim te administratorit ose te njerit prej ortakeve dhe me miratimin e Asamblese se Ortakeve.

#### NENI 7

Administrator i kesaj shoqerie do te jete BUJAR QIRKO, i cili do te ushtroje dhe do te ndjeki aktivitetin e shoqerise duke zbatuar kompetencat perkatese sipas dispozitave te statutit te shoqerise.

#### NENI 8

Fillimi i aktivitetit te kesaj shoqerie nis me regjistrimin e saj ne regjistrin tregetar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane si dhe me pajisjen me licence nga dega e tatimit.

#### NENI 9

Aktiviteti ekonomik dhe investimet e kesaj shoqerie mbrohen nga legjislacionin shqiptar ne fuqi.

#### NENI 10

Per ruajtjen e sigurimin e pasurive te lujteshme dhe te palujteshme kjo shoqeri mund t'i drejtohet cdo shoqerie te sigurimeve ne qender dhe ne degen e tij.

#### NENI 11

Dispozitat me te hollesishme jane parashikuar dhe parashtruar ne statutin e kesaj shoqerie e cila shpreh vullnetin e lire te ortakeve te kesaj shoqerie.

#### NENI 12

Ky Akt Themelimi është hartuar më 07.02.2007, në Tiranë, në katër kopje te barazvleshme, në gjuhën shqipe, duke pasur të gjithë fuqi të barabartë ligjore.

### O R T A K E T

**BUJAR QIRKO**

*Bujar Qirko*  
*Boeni*

**MAKSIM MUÇI**

**FREDI MUÇI**  
*Fredri Muçi*  
*[Signature]*

*Maksim Muçi*  
*[Signature]*

*[Signature]*  
*[Signature]*

# STATUTI

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"E R B "Sh.p.k

Ne baze te ligjit 7638, date 19.11.1992 ne ortaket

1. **Zoti Bujar Qirko**, i biri i Sokratit, lindur në Gjrokaster më 24.02.1948, banues në  
Tirane, qe mban pasaporten me Nr. Z 0000128

2. **Zoti Maksim Muçi** i biri i Thimjos, lindur në Gjrokster më 12.01.1948, banues në  
Tirane, qe mban pashaporten me Nr. Z 0667780

3. **Zoti Fredi Muçi** i biri i Thimjos, lindur në Gjrokaster më 14.09.1952, banues në  
Gjrokaster , qe mban pashaporten me Nr. Z 1149800

Vendosem qe te krijojme Shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "E R B "shpk.

### NENI 1

#### FORMA

Shoqeria krijohet dhe ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe veçanerisht, por jo ekskluzivisht, me nenet 11, 12 te ligjit 7491 date 21.04.1991, per dispozitat kryesore kushtetuese, ligjin 7594 date 04.08.1992, per investimet e huaja, ligji Nr. 7638 date 19.11.1992 per shoqerite tregtare, ligji 7667 date 28.01.1993, per regjistrin tregetar, aktet e tjera ligjore qe do te jene ne fuqi gjate veprimtarise se shoqerise, si dhe me dispozitat e statutit te shoqerise dhe aktit te themelimit.

### NENI 2

#### EMERTIMI SHOQERISE



Emertimi I Shoqerise eshte Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar " E R B "shpk.


### NENI 3

#### SELIA

Selia e Shoqërisë ndodhet në Tirane, ne adresen: Rruga "Gjon Muzaka" Nr. 40/2, me te drejte per te ndryshuar qendren e saj si dhe per te hapur dege e filiale te tjera, agjensi perfaqesimi ne te gjithë Shqiperine si dhe jashte saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

### NENI 4


## OBJEKTI SHOQERISE

Shoqëria do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj:

- Mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit- montimit, studimin dhe projektimin e objekteve,
- Konsulencën dhe kontrollin teknik të projekteve, vlerësimin e pasurive të lujtshme e të palujtshme dhe çdo veprimtari tjetër në përputhje me licencat e fituara të saj.
- Prodhimin e materialeve të ndërtimit dhe tregtimin e tyre, import eksportin e mallrave të ndryshme makinerive pajisjeve etj. në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.
- Kryerjen e veprimtarisë së shërbimeve të ndryshme të karakterit mekanik, elektrik, elektronik, komunal, publicistike etj.
- Investimin e kapitalit dhe mjete të tjera financiare, për blerje të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme dhe në vazhdim të aktivitetit të saj të shesë të tilla, për të arritur qëllimet e Shoqërisë, apo të tjera, por që janë të vlefshme për të.
- Studimin dhe krijimin e linjave të prodhimit të çdo lloji artikulli të gatshëm apo gjysëm të gatshëm, ndërtimit- montimit të objekteve të ndryshme.
- Kryerjen e të gjitha operacionet bankare apo financiare si: depozitime, kreditime, likuidime të parave, etj., në kushtet e përcaktuara nga legjislacioni shqiptar. Dhënie e konsulencës dhe kryerjen e shërbimeve në lidhje me veprimtarinë e mësipërme dhe në të tjera.
- Realizimin e kontratave, marrëveshjeve, ortakërive, shoqërive të përbashkëta tregtare, industriale, apo forma të tjera të lejuara nga legjislacioni shqiptar, me persona fizikë dhe juridikë, shqiptarë ose të huaj, për të realizuar veprimtari të ndryshme që janë të nevojshme dhe me interes për Shoqërinë.

## NENI 5

### ADMINISTRATORI


Administrator i kësaj shoqërie do të jetë BUJAR QIRKO, i cili do të ushtroje dhe do të ndjekë aktivitetin e shoqërisë duke zbatuar kompetencat përkatëse sipas dispozitave të statutit të shoqërisë.

## NENI 6

### KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e kësaj shoqërie do të jetë me një afat kohe mbi 10 vjet, duke filluar nga data e regjistrimit në gjykatë.

Kjo periudhë mund të zgjatet tej këtij afati ose të shkurtohet kur shoqëria prishet para afatit.



## NENI 7

### KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 leke. Ky kapital përbëhet nga kontributet e mëposhtme :

1. Z. Bujar Qirko, kontribuon në shumën 33,3 % të kapitalit ose 1/3 të kuotave, me vlerë 33.300 ( tridhjetë e tremije e treqind) leke.
2. Z. Maksim Muçi, kontribuon në shumën 33,3 % të kapitalit ose 1/3 të kuotave, me vlerë 33.300 ( tridhjetë e tremije e treqind) leke.
3. Z. Fredi Muçi, kontribuon në shumën 33,3 % të kapitalit ose 1/3 të kuotave, me vlerë 33.300 ( tridhjetë e tremije e treqind) leke.

Fondet që rrjedhin depozitohen në Bankën përkatëse në llogari të shoqërisë që krijohet. Kapitali Themeltar mund të shtohet ose pakesohet me vendim të Asamblesë së Ortakeve. Çdo ndryshim i kapitalit themeltar pasqyrohet në librin e shoqërisë. Kapitali mund të rritet edhe me kontributet në natyrë. Ndryshimi i kapitalit kryhet me propozim të ortakeve dhe me miratimin e Asamblesë së Ortakeve. Kapitali mund të rritet edhe me kontributet në natyrë.

Ndryshimi i kapitalit kryhet me propozim të administratorit ose të njerit prej ortakeve dhe me miratimin e Asamblesë së Ortakeve.

## NENI 8

### ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Shoqëria do të administrohet dhe do të drejtohet nga ortakët e kësaj shoqërie. Krahas ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë do të organizohet dhe do të përmirësohet struktura administrative e saj, ashtu siç do ta shohin të arsyeshme ortakët e saj.

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë :

- Asambleja e Ortakeve
- Administratori.



Kompetencat kryesore të Asamblesë së Ortakeve janë:

- Te bëjnë ndryshime në objektin e veprimtarisë së shoqërisë.
- Te miratojnë rezultatet vjetore.
- Te organizojnë, të shpërndajnë dhe të mbyllin shoqërinë.
- Te vendosin për çmimet e punimeve që do të bëjë shoqëria.
- Te emerojnë personelin, të vendosin shpërblimin e tyre, të marrin punonjës me kontratë pune, etj.

Administratori përfaqëson shoqërinë përpara organeve gjyqësore, organeve administrative të shtetit, para çdo personi fizik apo juridik, terheq kredi nga Bankat apo institucione të tjera kredithënëse, cakton avokat, etj

## NENI 9

Emertimi i kësaj shoqërie do të shoqëroje të gjithë dokumentacionin kryesor të nxjerre nga kjo shoqëri si dhe të gjithë dokumentacionin që ka lidhje me marrëdhënjet



e saj me te tretet dhe kjo shoqeri do te kete vulen e saj, e cila do te kete formen dhe madhesine e zakonshme dhe me tekstin perreth saj, vule e cila do te shoqeroje te gjithë dokumentacionin e nxjerre nga kjo shoqeri.

#### NENI 10

Kjo shoqeri me pergjegjesi te kufizuar konsiderohet e krijuar dhe merr forme te plote juridike me rregjistrimin e saj ne rregjistrin tregetar te Gjykates se Shkalles se Rrethit Gjyqesor ne Tirane, si dhe merr fuqi per zhvillimin e aktivitetit te saj ekonomik me marrjen e licences nga Zyra e Tatimeve.

#### NENI 11

##### EKSPERT KONTABEL TE AUTORIZUAR

Ne rast nevojë ose ne se e kerkon ligji kontrolli i shoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i emeruar per tre vite financiare.

Shkarkimi i ekspertit kontabel te autorizuar vendoset ne te njetat kondita si emerimi, ne rast se verehen gabime ose behet e pamundur kryerja e detyres.

#### NENI 12

##### VITI FINANCIAR ,LLOGARITE VJETORE

Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor ,me perjashtim te vitit te pare qe fillon duke u nisur nga data e rregjistrimit te shoqerise ne Rregjistrin Tregetar prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Te gjitha veprimet financiare te shoqerise mund te kryhen nepermjet veprimeve me bankat shqiptare,ku shoqeria do te çele llogarine rrjedhese,ne perputhje me legjislacionin kontabel dhe financiar ne fuqi.Shoqeria eshte e lire te kerkoje financim dhe kreditim nga çdo banke apo institucion fiannciar i huaj apo shqiptar


Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e veçanta te hartuara nga administratori dhe eventualisht nga eksperti kontrabel i autorizuar miratohet nga Asambleja e Ortakeve .

##### ZGJATJA E AFATIT, PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

#### NENI 13

Me perfundimin e afatit te percaktuar ne kete statut, zgjatja e tij mund te vendoset me Mbledhjen e Asamblese se Ortakeve

#### NENI 14



Shoqeria priset me perfundimin e e afatit te percaktuar nga statuti me perjashtim te rasteve kur e shesh te arsyeshme Mbledhja e Asamblese se Ortakeve , per arsye te parashikuara ne ligj.

## NENI 15

### SHPERNDARJA E LIKUJDIMI I SHOQERISE

Kjo shoqeri e ndryshon aktivitetin dhe menyren e organizimit te saj me ane te shperndarjes, e cila mund te behet ne rast se nuk e ushtron aktivitetin e saj ose ne rast te forces madhore, po keshtu edhe ne formen e likujdimit. Per likujdimin e saj me vendim te Asamblese se Ortakeve, mbas miratimit te bilancit perfundimtar shpallet likujdimi i shoqerise. Pas kesaj shpallje kryhen te gjitha veprimet e nevojshme, çrregjistrimi i saj nga rregjistrimi i Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane dhe nga Zyra e Tatimeve.

## DISPOZITA TE FUNDIT

## NENI 16

Te gjitha ndryshimet qe do te pasojne ne legjislacionin shqiptar ne lidhje me shoqerite tregetare te krijuara, po te jete e nevojshme do te pasqyrohen ne dispozitat e ketij statuti.

Per mosmarreshjet qe mund te lindin mes shoqerise dhe ortakeve do te zbatohen dispozitat e Aktit te Themelimit dhe Statutit te Shoqerise. Per rastet e tjera qe lidhen me te tretet problemet trajtohen ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Persa nuk parashikohet ne kete statut i referohemi dispozitave qe permbahen ne ligjin Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite Tregetare" dhe legjislacioni Shqiptar.

## NENI 17


Ky Statut është hartuar më 07.02.2007, në Tiranë, në katër kopje te barazvleshme, në gjuhën shqipe, duke pasur të gjithë fuqi të barabartë ligjore.

## O R T A K E T


BUJAR QIRKO




MAKSIM MUÇI



FREDI MUÇI



Tirane, me \_\_\_\_\_





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr 230 Rep.  
Nr 00 Kol.

VERTETIM

Sot me daten 07 Shkurt 2007 (dymije e shtate) ,para meje noteres Nexhla KELLEZI, me Zyre ne Bulevardin "Gjergj Fishta", Kulla 1, u paraqiten personalisht ortaket e mesiperm: **1. Zoti Bujar Qirko**, i biri i Sokratit, lindur në Gjrokaster më 24.02.1948, banues në Tirane, qe mban pasaporten me Nr. Z 0000128, **2. Zoti Maksim Muçi** i biri i Thimjos, lindur në Gjrokster më 12.01.1948, banues në Tirane, qe mban pashaporten me Nr. Z 0667780 dhe **3. Zoti Fredi Muçi** i biri i Thimjos, lindur në Gjrokaster më 14.09.1952, banues në Gjrokaster , qe mban pashaporten me Nr. Z 1149800, te tre madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, te cilet me deklaruan se sa me siper eshte bere me vullnetin e plote e te lire te tyre, jashte kesaj zyre, prandaj e firmosin ate rregullisht para meje noteres dhe une noterja e vertetoj neneshkrimin e tyre sipas ligjes.



Notere  
Nexhla Kellezi  
07/02/2007